



Numër falas



Shkupi

lajmëtari

shtator, 2018



fq. 5

Historia e futbollit
në Shkup

fq. 8

Intervistë: Përbërësi sekret
që pushtoi botën

fq. 18

Njihuhet me shkupjanët

fq. 20

Qyteti i bukur mbiu përsëri

Në maj të vitit 2018, në Muzeun e Qytetit të Shkupit u mbajt ekspozita „Vertikalet e Shkupit“ e ekipit të autorëve: Jovan Ivanovski, Ana Ivanovska Deskova dhe Vladimir Deskov. Ekspozita, e përcjellë me publikimin me të njëjtin titull përbën rezultat të një hulumtimi rrënjësor të ndërtesave të larta në Shkup, si një nga elementet më specifike dhe më të spikatura të cilat ndikojnë fuqishëm në formimin e karakterit bashkëkohor të qytetit. Duke ndjekur një metodologji të zakonshme të punës hulumtuese (planifikim i gjerë, vlerësim dhe përzgjedhje më e ngushtë, grumbullim dhe përgatitje e materialeve grafike, përgatitje e fotografive, përgatitje e modeleve arkitektonike, prezantim publik...), ky punim para publikut prezantoi rreth 50 ndërtesa të larta të cilat i përkasin periudhës së viteve pesëdhjetë deri në fund të viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar.

Në mënyrë të ngjashme me qytetet e tjera evropiane, historia e vertikaleve në Shkup mund ndiqet nëpër të gjitha epokat e zhvillimit historik të arkitekturës - nga kullat e spikatura të mbrojtjes jashtë Kalasë së Shkupit



Nga ekspozita „Vertikalet e Shkupit“, fotografi: Vase Amanito

VERTIKALET E SHKUPIT

Ana IVANOVSKA
DESKOVA
Vladimir DESKOV
Jovan IVANOVSKI

dhe të atyre përreth; përmes pikave referuese me karakter religjioz (kullat e kambanave dhe minaret); pikave referuese profane - kulla e sahatit; objekte të cilat me lartësinë e tyre flasin për pozitën e lartë shoqërore - Kulla e Beut, etj. Megjithatë, vertikaleiteti dhe zhvillimi i qytetit në lartësi kuptimin e vërtetë e marrin në periudhën e pasluftës nëpërmjet kullës shumëkatëshe si një nga karakteristikat kryesore dhe simbole të qytetit modern.

NË RINDËRTIMIN PAS TËRMETIT QYTETI U MODERNIZUA NË MËNYRË DRASTIKE

Procesi intensiv i modernizimit i cili fillon të ndryshojë pamjen e Shkupit që në vitet pesëdhjetë të pasluftës, dhe veçanërisht në mënyrë dramatike në periudhën e rindërtimit të qytetit pas tërmetit (nga fundi i viteve gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë dhe gjysma e parë e viteve tetëdhjetë), do të fusë paradigma të reja, moderne në lidhje me planifikimin e hapësirës dhe në aspektin e strukturës së saj të ndërtuar. Bëhet fjalë për një periudhë të historisë arkitektonike të Shkupit, kur zhvillimi i qyteteve edhe në nivel global ende konsiderohet si një „punë publike“; si një mjet emancipues i rëndësishëm dhe veçanërisht si një mjet për përmirësimin e jetës sociale dhe kulturore.

Kështu, në periudhën e modernizimit intensiv të Shkupit, modeli vertikal i „banimit“ dhe rritja e qytetit zë një vend të rëndësishëm në kompozimet arkitektonike dhe urbanistike, si nga plani simbolik, ashtu edhe për shkak të tipologjisë specifike. Duke u rritur në lartësi, ndërtesat vertikale në të njëjtën kohë sigurojnë edhe dendësi të lartë, por edhe lirojnë një sipërfaqe të madhe



Kulla banesore tip „K7-K9“ / bul. ASNOM
nr. 70 / arkitekt Voislav Filevski / 1979.
fotografi: Vase Amanito



Nga hapja e ekspozitës „Vertikalet e Shkupit”, fotografi: Elena Fidanska

BUXHETI I SAKTË DHE MODEST NXISIN MENDIMIN KREATIV DHE DËSHIRËN PËR TË SIGURUAR MODEL ADEKUAT RACIONAL

e cila më tej mund të shfrytëzohet si hapësirë e përbashkët, publike dhe e rregulluar. Baza relativisht e vogël dhe kompakte mundësuan përsëritjen e katit karakteristik në lartësi, në suazat e hapësirave racionale konstruktive. Vendosja e lirë në hapësirën e qytetit siguron orientacion të volitshëm, ekspozim ndaj diellit dhe pamje të mira për ambientet e brendshme banesore ose të punës. Gjatë kësaj, rritja e qytetit në lartësi mbështetet mbi zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit.

Në rastin e Shkupit, është veçanërisht e rëndësishme periudha e rindërtimit pas tërmetit në të cilën industria e ndërtimit kalon nëpër një proces thelbësor rishikimi në drejtim të prodhimit më racional – kosto më të ulët të materialeve dhe konstruksioneve gjatë procesit ndërtimor, unifikim, standardizim dhe prodhim masiv. Fronti madhor i njëkohshëm i ndërtimeve, volumi dhe kompleksiteti i ndërtimeve etj., konfirmuan rritjen e operativës ndërtimore dhe aftësimin e saj për të realizuar vepra komplekse, por edhe për të mbështetur dhe stimuluar hulumtime të ndryshme

dhe zhvillimin e koncepteve të reja arkitekture. Buxheti i saktë dhe jo rrallëherë edhe modest (veçanërisht kur bëhet fjalë për ndërtimet banesore) nxisin mendimin kreativ dhe dëshirën për të siguruar një model adekuat. Për shkak të imperativit për një racionalitet sa më të madh zakonisht mund të pritej reduktim i çdo ornamenti në shprehjen arkitektonike; përkundrazi, në vitet pas tërmetit (vitet 70-të dhe 80-të) është



Kulla Autokomanda / rr. Jani Lukrovski nr. 2 / arkitekt Trajko Vasilev / 1972. fotografi: Vase Amanito

shprehur fuqimisht tendenca për rritjen e skulpturalitetit edhe në plastikën e ndërtimeve të shkallës së parë dhe të dytë. Me entuziazëm dhe besim të madh në rezultate eksperimentohet, para së gjithash, në përsosmërinë e punës me beton (si ilustrim mund të shërbejë konvikti i studentëve „Goce Delçev“, objektet e Qendrës së telekomunikacionit, Banka popullore e RM-së etj.)

Në shumicën e realizimeve, ndërtesa të caktuara dallohen për nga ambicia e tyre e jashtëzakonshme arkitektonike dhe cilësia. Tek ta ambienti, struktura dhe indi janë të lidhura në mënyrë të ndërsjellët me mënyra komplekse dhe sugjesteve.

Edhe përkundër cilësive të theksuara, ndërtimet vertikale nuk do të mund të shmangin (tek ne e vonuar) krizën dhe kritikën e Modernes – si për sa i përket „shpërbërjes“ së pamjes së qartë, historike të qytetit ashtu edhe për sa i përket dendësisë së lartë, tjetërsimit dhe izolimit (pikërisht si pasojë e një dendësie të tillë), të krahasuara me mënyrën e mëparshme, më pak mitologjike të mënyrës së jetesës dhe punës.

EDHE PSE NDËRTIMET E KOHËS SË RE TË TRANZICIONIT PUSHTOJNË HAPËSIRËN E QYTETIT, MATRICA E FUQISHME MODERNISTE EDHE MË TEJ VAZHDON TË DOMINOJË ME PANORAMËN NË QYTET

Vitet e shpërbërjes së sistemit shoqëror-politik socialist, të shoqëruara me një tranzicion të gjatë drejt një sistemi liberal kapitalist çojnë drejt krijimit të kushteve krejtësisht të reja për zhvillimin e arkitekturës në qytet. Shteti nuk e

ka më fuqinë për të qenë planifikuesi, financieri, realizuesi kryesor i ndërtimit, ndërsa në politikat e reja të menaxhimit me hapësirën nuk ekziston ide universale ose narrativ në lidhje me çështjen e interesit publik ose të mirave kolektive. Shkatërrimi i sistemit të vlerave përfundimisht çon drejt zëvendësimit të narrativit humanist (post-modernist) dhe zhdukjes graduale të koncepteve të caktuara urbanistike dhe arkitekturore për zhvillimin e qytetit, ndërmjet të cilave edhe tipologjia e ndërtesave vertikale. Edhe pse ndërtimet e kohës së re të tranzicionit pushtojnë me shpejtësi hapësirën e qytetit, duke e mbushur me substancë ndërtimore pa ndonjë cilësi arkitektonike të veçantë, matrica e fuqishme e vertikaleve të Shkupit dhe karakteri i theksuar i tyre vazhdon të dominojë me panoramën e qytetit. Në këtë drejtim, shumica e pamjeve mbresëlënëse të ndërtesave të larta akoma gjenden në lidhje aktive me strukturën e qytetit modern, duke përbërë një element të rëndësishëm edhe të identitetit të tij bashkëkohor.

Edhe vetë fakti se shoqëria bashkëkohore maqedonase tashmë dekada me radhë po heziton rreth idesë për pranimin (ose refuzimin) e trashëgimisë së vet moderniste, flet qartë se modernizmi (Modernia) asnjëherë nuk është ngulitur aq sa duhet as në suazat e arkitekturës (profesionale), e aq më pak ndërmjet publikut më të gjerë. E gjitha kjo, së bashku me mungesën e fushës adekuate shkencore, ishte një nxitje e mjaftueshme për hulumtimin e shembujve karakteristikë të arkitekturës së vertikaleve të Shkupit – rezultat i imagjinatës autentike arkitekturore, e cila meriton të nxirret nga harresa, të njihet, kuptohet dhe vlerësohet në mënyrë adekuate.



Kulla banesore / rr. „Metodij Satorov Sarlo“ nr. 14 – nr. 18 / arkitektë: Dragan Tomovski, Nikola Lagudin, Kiril Muratovski, Atanas Bancotovski, Vasilka Ladinska, Simeon Apostolski / 1975. Fotografi: Vase Amanito



Kulla banesore / rr. „Bojmija“ nr. 2 - nr. 8 / arkitekt Vasilka Ladinska / 1982. fotografi: Vase Amanito

HISTORIA E FUTBOLLIT NË SHKUP

Historia e futbollit në Shkup fillon me ndeshjen e futbollit në vitin 1909 që u luajt nga dy ekipe të ushtarëve turq në oborrin e Shkollës së mësuesve të atëhershme, sot në afërsi të Shtabit të përgjithshëm të ARM-së. Që atëherë kanë kaluar 109 vjet, kurse futbollit në Shkup akoma është loja më e preferuar sportive. Në disa sezona me suksese më të mëdha, në disa me suksese më të vogla, klubet e futbollit të Shkupit nëpër vite dominojnë në skenën e futbollit vendas dhe bëjnë përpjekje për të hyrë në gara më të mëdha evropiane dhe botërore. Tifozët besnikë janë gjithmonë këtu për të mbështetur ekipin e tyre, sepse për ekipin e vet brohorasin edhe kur fiton edhe kur humbet. Për të gjithë adhuruesit e futbollit dhe për të gjithë tifozët e klubeve të Shkupit, në faqet e mëposhtme ju transmetojmë një pjesë të historisë së futbollit në Shkup.

KF USKUP – KLUBI I PARË I FUTBOLLIT NË SHKUP

Nuk dihet saktë se cili ka sjellë topin e parë të futbollit në Shkup, por dihet se klubi i parë i futbollit është formuar në vitin 1911 me emrin SK "Uskup" (Shkup). Pas përfundimit të luftërave ballkanike në vitin 1915 në Shkup u formua KF "Voinoviq", në të cilin luanin futbollistë të cilët kishin luajtur edhe për klubin e futbollit nga Zagrebi dhe "BSK" nga Beogradi, dhe që studionin jashtë Shkupit. Trajnimet dhe ndeshjet i mbanin në fushën të Shkollës së mësuesve e mëparshme.

Më tej, në vitin 1919 u shfaq edhe një klub tjetër, KF "Napredok", dhe pastaj edhe klubet e futbollit "Zora" dhe "Bratstvo", por shumë shpejt u bashkuan me klubin



Monumenti për ndeshjen e parë të futbollit në Shkup, në vitin 1909

"Napredok". Ditën e parë të Pashkëve më 20 prill 1919 KF "Napredok" luajti ndeshjen e parë zyrtare të futbollit me klubin e oficerëve të shkollës angleze, në të cilën "Napredok" fitoi me rezultatin 2:0. "Napredok" në korrik të vitit 1919 luajti edhe ndeshjen e parë ndërkombëtare në Shkup me "Makabi" të Selanikut, duke shënuar fitore me rezultatin 7:0.

Futbollit në Shkup bëhet gjithnjë e më popullor dhe në vitin 1921 u formuan tre ekipe: "SSK", "Ballkan" dhe "Pobeda". "Ballkan" është klubi i parë nga Shkupi i cili në vitin 1922 u regjistrua në „Belgradski loptaski potsojuz". "Pobeda", nga ana tjetër, trajnonte dhe luante ndeshjet e saj në terrenin e improvizuar në qendrën e qytetit, në afërsi të pazarit të gjelbër të sotëm.

Më tej, në të njëjtin vit, vazhdon formimi i klubeve të reja në Shkup – "Vardar" nga Topana dhe KF "Gragjanski". Diçka më vonë, në Shkup u themelua edhe një klub KF "Makedonija", dhe pastaj në vitin 1924 edhe KF "Sparta" dhe klubi i njohur "Sloga" i Çairit. U formua edhe "Nënkomiteti i futbollit të Shkupit" në të cilin merrnin pjesë klubet: "Maçva", "Crna Gora" dhe "Slavija" (1929), "Olimpija", "Jugoviq" dhe "Mac" (1930),

"Hajduk" (1931), "Jug", "Hask" dhe "Rapid" (1932), "Singeliq" dhe "Dushan Silni" (1935). Në vitin 1937 në Shkup u formua një nga klubet më të njohura të Shkupit KF "Rabotnički".

KF "Gragjanski" është klubi i parë në Shkup që në sezonin 1937/38 para fillimit të Luftës së dytë botërore luajti në Lidhjen Federale të Jugosllavisë së atëhershme të Jugosllavisë me "Hajduk" nga Spliti, "Gragjanski" nga Zagrebi dhe me "BSK" nga Beogradi. Klubi u klasifikua në vendin e nëntë me shtatë fitore, dy barazime dhe tri humbje. Trajneri i ekipit ishte i njohuri Iles Spic.

Më 10 gusht 1941, u formua klubi "Makedonija" në Shkup, i cili luajti në Lidhjen Kombëtare të Bullgarisë



Llojtarët e KF „Gragjanski“

deri në vitin 1943. KF "Makedonija" luajti ndeshjet e tij në stadiumin e atëhershëm në parkun e qytetit, të ndërtuar me konstruksion druri dhe me kapacitet prej rreth 5.000 spektatorë. Për KF "Makedonija" atëherë luanin edhe futbollistët e njohur - Xhina, Jane Janevski, Portieri Vasil Dimov, Stojan Bogoevski - Gajda dhe të tjerë. Në fund të vitit 1943 u krijua Liga e Shkupit ku morën pjesë "Makedonija", "Liria", "Sloboda", "Rabotnički", "Shar", "Pobeda", "Vardar" nga Topana, "Botev" dhe "Ballkan", në të cilën vendi i parë u fitua nga "Makedonija".

HAPET SEZONI I FUTBOLLIT NË MAQEDONINË E ÇLIRUAR



KF „Pobeda“ para bashkimit me KF „Makedonija“

Më 17 shkurt 1946, në Shkup u hap zyrtarisht sezoni i futbollit në Maqedoninë e lirë, me kampionatin e qytetit. Në grupin e parë luajtën "Makedonija", "Pobeda", "Rabotnički", "Edinstvo" dhe "Shari", kurse në grupin e dytë merrnin pjesë, "Luboten" dhe "Industrialec" nga Gjorçe Petrov. "Makedonija" dhe "Pobeda" ishin më të suksesshmet, kurse "Rabotnički" nëpërmjet kualifikimeve në ndeshjet me "Proleter", së bashku me këto dy klube, u klasifikua në Ligën e Parë Maqedonase, e cila atëherë u formua për herë të parë. Kampion i parë i Maqedonisë në futboll ishte ekipi i "Pobeda" nga Shkupi, për të cilin luanin Gjorgji Cincievski - Xhinka, Hristo Hristovski - Mulac, Dragan Georgievski etj. Si kampion i Maqedonisë, "Pobeda" u bë anëtar i Ligës së Parë të futbollit në Jugosllavi në të cilën në konkurrencën ndërmjet 12 ekipeve në vitin 1946/47 fitoi vendin e tetë me tetë fitore, gjashtë barazime dhe 12 humbje, me golavarazh 41:49.

Më 20 qershor 1946, në Shkup u luajt ndeshja e parë ndërmjet "Rabotnički" dhe "Makedonija", në të cilën fitoi "Makedonija" me rezultatin 1:0. Anës terrenit, u vendosën 14 reflektorë me fuqi 1400 dhe 1600 wat të cilat u sollën nga



„Vardar“ - fitues i Kupës së Jugosllavisë



Futbollistët e „Sloga Jugomagnat“, viti 1987

Teatri maqedonas.

Me vendimin e Këshillit të fizkulturës së Maqedonisë fillon Liga maqedonase me 10 klube për sezonin 1946/47 në të cilën morën pjesë "Maqedonia", "Rabotnički", "Zafer" dhe "Edinstvo" nga Shkupi. Kampioni i dytë i Maqedonisë në mënyrë bindëse ishte KF "Makedonija" me 6 pikë para "Rabotnički" të dytë. KF "Makedonija" luajti në kualifikimin për klasifikimin në Ligën e parë të Jugosllavisë me "Dinamo" nga Pançevo. Në Shkup klubi fitoi 3:1, në ndeshjen e kthimit humbi me rezultatin 2:0, kurse në ndeshjen e tretë në Zrenjanin humbi me rezultatin 2:1 dhe nuk u kualifikua në Lidhjen e Parë të Jugosllavisë. Për KF "Makedonija" luanin Blagoja Petrovski - Bala, Savo Cvetković, Vasko Kokinovki - Makara, Dragan Gerov - Gagush dhe të tjerë.

Lidhja e Futbollit e Jugosllavisë pas kampionatit të Ligës së Parë të Jugosllavisë në sezonin 1946/47 vendosi të reduktojë ligën nga 14 në 10 klube, kurse "Pobeda" të largohet nga Liga.



Ekipi kampion i Vardarit - sezoni 1986/87

Por klubi "Makedonija" kishte një mundësi të re për të luajtur kualifikime për të hyrë në ligë. Atëherë, Lidhja maqedonase vendosi të bashkojë klubet e futbollit "Makedonija" dhe "Pobeda", gjë që u bë më 19 qershor 1947, kur u formua klubi më prestigjioz i futbollit në Maqedoni - "Vardar" nga Shkupi. Në kualifikimet për Ligën e Parë, KF "Vardar" luajti barazim 1:1 me FK "Sloga" (më vonë FK "Vojvodina") në ndeshjen e parë në Novi Sad. Goli i vetëm për KF "Vardar" u shënuar nga Savo Cvetković.

Në ndeshjen e kthimit në Shkup, KF "Vardar" udhëhoqi me golin e Savo Cvetković për 1:0, por mysafirët të pakënaqur me vendimin e arbitrit për të pranuar golin u larguan nga fusha dhe KF "Vardar" u bë anëtar i Ligës së Parë të Jugosllavisë, në të cilën vite me radhë luajti me sukses të madh, deri në pavarësinë e vendit tonë.


"VARDAR" FITUESI I KUPËS SË JUGOSLLAVISË

"Vardar" ka qenë fitues i Kupës së Jugosllavisë "Marshall Tito" në vitin 1961. Në atë ekip kanë luajtur: Tode Georgievski, Blagoja Vuçidolov, Petar Angjushev, Slavko Daçevski, Dragan Trajčevski, Časlav Bozhinovski, Vlado Nikolovski, Stojan Velkovski, Andon Dončevski, Mirko Ilievski, Petar Sulincevski. Në finalen e Kupës, KF "Vardar" mundi KF "Varteks" nga Varazhdini me rezultatin 2:1.

KF "Vardar" arriti suksesin e tij më të madh në sezonin 1986/87, kur u shpall kampion i Jugosllavisë. Në ekipin kampion të Vardarit luanin Momčilo Groshev, Vujadin Stanojkovič, Mile Simovski, Vencislav Simonovski, Nikola Avramovski, Ilija Najdoski, Toni Savevski, Dragan Kanatlarovski, Petar Georgievski, Boban Babunski dhe Darko Pančev.

Suksesin më të madh deri në ditët e sotme në ndeshjet ndërkombëtare KF "Vardar" e arriti në sezonin e 2017/2018 kur u kualifikua në fazën në grupe në kompeticionin Europa League, duke mposhtur gjigantin turk "Fenerbahçe" nga Stambolli në ndeshjen e play-off.

Një nga klubet më të vjetra të futbollit të Shkupit "Rabotnički" luajti dy herë në Ligën e Parë të Jugosllavisë në vitin 1952 dhe në sezonin 1953/54, me një ekip të mirë të udhëhequr nga Vojçe Dimitrovski, Bozho Vuçinovski, Spire Petrovski, Dokse Damjanov dhe të tjerë. Në kupat evropiane ka marrë pjesë edhe KF "Sloga" nga Čairi, më vonë "Sloga" Jugomagnat, dhe sot Shkupi. Tri herë radhazi, "Sloga" ishte kampion i Maqedonisë në 1999, 2000 dhe 2001, dhe fitues i Kupës së Maqedonisë në 1996. Në ekipin kampion luanin Lipovski,



Stadiumi i Čairit

Memedi, Beqiri, Shabani, Beganovič, Alomerovič. Klubi u shfaq për herë të parë në skenën evropiane në vitin 1996 në Kupën e Fituesve të Kupave kundër KF "Honved" nga Hungaria.

Nga klubet e Shkupit në kualifikimet për Kupat evropiane kanë luajtur "KFU 55", më vonë "Cementarnica". Për "Cementarnica" atëherë luanin Kmetovski, Čolakovič, Beganovič, Vandaire, Grozdanovski, Blesing ...

Klubi i futbollit "Makedonija Asiba" nga Gjorçe Petrov është klubi i pestë nga Shkupi i cili ka luajtur në Kupën Intertoto kundër KF "Olimpija" dhe KF "Bastia" në vitin 1998. Në Kupën UEFA ka luajtur edhe klubi i futbollit "Metalurg" nga Autokomanda, duke filluar nga viti 2011 kur ishte edhe fitues i Kupës së Maqedonisë.

KLUBE TË DENJA PËR T'U MBAJTUR MEND

Në ish-ligat e Jugosllavisë nga klubet e futbollit Shkup përveç "Vardar" dhe "Rabotnički" kanë luajtur klubet e futbollit dhe "Milicioner" (më vonë

"Dinamo"), MIK (më parë "Industrialec", "Shkupi" i sotëm), "Metalurg" dhe "Ballkan". KF "MIK" kishte një ekip të fortë të udhëhequr nga portieri Lazov Boro Uzunov Ljubisha Nikolič Eduard Palič, Vasil Zigomanov, ndërsa për Metalurg luanin Nexhat Shabani, Sasha Qirič, Zlate Miloshevski, Borçe Setinov, Mijač Mihailov, Antonio Filevski. Në ekipin e "Ballkan" përveç të tjerëve luanin edhe Cene Aleksandrovski, Dejan Kusinski, Ljupčo Rafevski, Goce Dimovski.

Të mos harrojmë edhe ndeshjet e klubeve të futbollit "Metalec", të formuar në vitin 1946, për t'u bashkuar në vitin 1964 me KF "Industrialec". Për klubin luanin Gjorgji Cincievski, Jovo Nikushev, Tome Dimovski, Ceko Vidinski, Nikola Sarevski.

Nga klubet e tjera të Shkupit që kanë luajtur në kampionatet maqedonase përmendim "Alumina", Maxhari - më vonë "Maxhari Solidarnost", "Treska", "Trgovski", "Udarnici", "Fas 11. Oktomvri", "Fortuna", "Euromilk" SSK, "Tekstilec", "Student", "Zafer", "Bratstvo Edinstvo", "Slavija". Në ligat më të ulëta të qytetit të Shkupit merrnin pjesë: "Pivarnica", "Polet", "Postar", "Proleter", "Sloboda", Klubi i shurdhmemecëve, "Torpedo", "Hunap", "Nasha Krila", "Novinar", "Komunalec", "Kozarec", "Jug", "Jugopetrol", "Karposh 3", "Drvodelec", "Vlae", GSP, "22 Dekemvri", "Vanila", "Graditel" dhe "Alfos".

Në Shkup ka disa stadione në të cilat mund të luhen ndeshje të Ligës së Parë dhe të Dytë. Këto janë stadiumi i qytetit "Arena Filipi II", stadiumi "Boris Trajkovski" në Maxhari, stadiumi në Čair, stadiumi në Gjorçe Petrov, stadiumi i "Cementarnica", si dhe stadiumet në Gorno Lisiçe, "Lokomotiva" dhe "Alumina" në Karposh.



Tribuna jugore e Stadiumit të qytetit në vitet, 90-të

BISEDOJMË ME GJORÇE STAVRESKIN, REGJISOR I FILMIT „SHËRUESI“

PËRBËRËSI SEKRET

QË PUSHTOI BOTËN

Ai është një nga filmat maqedonas të vlerësuar më me shumë çmime. Vetëm për disa muaj filmi „Shëruesi“ fitoi zemrat e shikuesve, por edhe votat e jurive të festivaleve prestigjioze botërore të cilat e vlerësuan me çmime të shumta. Historia e mekanikut të depos hekurudhore, i cili duke mos pasur para për të blerë ilaçe i jep babait të tij ëmbëlsirë të bërë nga marijuana e vjedhur për të lehtësuar dhimbjet nga kanceri, bëhet objektivi i kriminelëve, që kërkojnë tu kthehet droga e vjedhur, por edhe i fqinjëve të cilët tek ai shikojnë shëruesin, na ngjiti në karriget e sallave të kinemasë dhe tronditi skenën filmike maqedonase.

Për frymëzimin, për përzgjedhjen e vendeve për xhirime, shpirtin e lagjeve të Shkupit të transmetuara në ekranet filmike dhe për suksesin e filmit „Shëruesi“ në këtë intervistë bisedojmë me regjisorin dhe skenaristin, Gjorçe Stavreski.

Në film mund të vërehen shumë lokacione nga Shkupi. Si i zgjidhët lokacionet? A kanë rëndësi të veçantë për Ju këto vende?

Lokacionet u përzgjedhën sipas ngjarjes së filmit e cila zhvillohej në Shkup. Vendimi për depon hekurudhore ishte i lehtë sepse ajo është depoja më afërt në qytet. Tjetra është në Veles. Banesa e Veles dhe lagja në të cilën jeton ishte më e vështirë për t'u gjetur. Shikuam lagje të ndryshme, ndërtesa dhe banesa. Një kohë „matnim“ banesat shumë të bukura dhe moderne të „Gradski zid“ të cilat ofrojnë një larmi vizionesh dhe këndesh

sepse janë të gjera dhe të projektuara mirë. Megjithatë hoqëm dorë sepse, edhe pse të vjetra, dukeshin luksoze në kontekstin e tregimit social të cilin e përgatitëm. Në fund vendosëm për një ndërtesë simpatike në Autokomandë me „ura“ specifike të cilat të çojnë drejt hyrjeve dhe mendoj se nuk gabuam. Ishte një vend shumë adekuat për tregimin. Problemi më i madh në film ishte vendi i kampit „Krani“ për të cilin në fund vendosëm se nuk duhet të xhirohet në kampin me të njëjtin emër në liqenin e Prespës, sepse kampi është krejtësisht i ndryshëm nga ai që unë mbaj mend si fëmijë. Liqeni „Treska“ dukej si një vend më adekuat për tregimin, e aq më tepër, shumë afër Shkupit.

Një pjesë e madhe e skenave në film zhvillohen në Autokomandë, si ndihmon kjo në tregimin e ngjarjes?

Siç thashë më sipër, lagja ishte shumë frymëzuese. Autokomanda është një lagje shumë e bukur, një mikrokosmos i pasur me ndërtesa, parqe, terrene sportive dhe një paqe me sharm të cilën nuk e gjen në qendrën e Shkupit. Gjithsesi, Autokomanda ka të njëjtat probleme ashtu si edhe një numër i madh lagjesh në Shkup, si infrastruktura e vjetruar, fasadat e shembura dhe popullsia që jeton në pragun e varfërisë. Megjithatë, për nevojat e filmit ishte pothuajse ideale dhe shumica e skenave të „lagjeve“ u xhiruan përreth këtyre ndërtesave, kështu që nuk kishte nevojë që të improvizojmë dhe të krijojmë një ambient „filmik“. Me një fjalë gjithçka u xhirua këtu, jo më larg se njëqind metra nga banesa e heroit kryesor.

Sa ju ka frymëzuar Shkupi për temën, skenarin, fotografitë?

Unë jam rritur në Shkup dhe e dua atë me të gjitha mangësitë dhe virtytet. Tragjedia „Shkupi 2014“ më shkaktoi dhimbje të madhe dhe ajo u shfaq edhe në një nga skenat kur Vele dhe Jana qëndrojnë në vendin e tyre nën urën elegante moderniste „Goce Delçev“ dhe shikojnë teatrin prej stiropori-barok më të vjetër edhe se teatri i vjetër i TKM-së. Dhe, kur filloi të shkatërrohet, nuk kishte fund. Për shembull, asnjëherë nuk kuptova pse është „sheshi i paformuar“ i cili mua më pëlqente shumë sepse ishte i gjerë dhe me hapësirë, ose pse duhej që „Debar maalo“ dhe lagje të tjera autentike të shkatërroheshin deri në atë masë. Dhjetë vitet e fundit shumë njerëz flasin me urrejtje për gjithçka që është ndërtuar pas tërmetit, duke hedhur tezën se ajo është me demokraci arkitektura e keqe dhe pa formë e socializmit përkundër neoklasicizmit të pagabueshëm (lexo: barok) të së kaluarës, duke mos kuptuar që arkitektura moderniste pas tërmetit në atë periudhë ishte në frymën e ngjarjeve botërore, fuqia e të cilave u konfirmua me ekspozitën e arkitekturës së Jugosllavisë në muzeun MOMA në SHBA.

Nuk mundemi të anashkalojmë edhe një element aktual, filmi juaj është i pari pas filmit „Para shiut“ që u shfaq në Greqi. Si u pranua atje?

Është një sukses i madh që filmi u gjend në distribucionin e kinemasë në Greqi, dhe kjo veçanërisht në momente delikate me aktualizimin e problemit me emrin. Isha në premierë dhe më



Filmi „Shëruesi“ është koproduksioni i parë maqedonas-grek. Premiera botërore e filmit ishte në „Festivali i filmit në Selanik“ më 9 nëntor 2017, premiera vendase në „Sinedejs“ në Shkup më 19 nëntor, kurse ajo ndërkombëtare në Talin në festivalin prestigjioz të kategorisë-A - „Mbrëmje të zeza“ më 25 nëntor 2017. Filmi „Shëruesi“ fitoi çmimin prestigjioz nga publiku në „Festivali i filmit në Selanik“, i cili në të njëjtën kohë është edhe çmimi i parë i këtij festivali që ndonjëherë i është dhënë ndonjë filmi maqedonas.

Filmi ishte fitues i çmimit special nga juria për skenar, në Festivalin mesdhetar të filmit në Bruksel, i çmimit për filmin më të mirë në Festivalin e filmit në Santa Barbara, SHBA, i çmimit special nga juria e Festivalit ballkanik të filmit në Sofje, e çmimit kryesor për filmin më të mirë në Bergamo Film Miting, Itali, i çmimit special nga juria e Frankofilm në Romë, e çmimit për filmin më të mirë në Festivalin e filmit në Obanj, Francë, e çmimit për filmin më të mirë në Let's CEE në Vjenë dhe e çmimit special nga Sinepleks në Vjenë, në prill të këtij viti.

pëlqeu shumë. Reagimet ishin shumë të mira, isha i ftuar në intervista të shumta, kemi recensionet të shkëlqyera, dhe këtu do të theksoj komentet e një kolegu më të ri i cili tha se ky është „filmi më grek, jo grek, të cilin e ka parë ndonjëherë“ (shumë ironike dhe qesharake në kontekstin e emrit), duke aluduar në problemet e ngjashme me të cilat ballafaqohen njerëzit në Greqi, fryma e njerëzve, shëndetësia, humori i shkatërruar, madje edhe shfaqja masive e Shëruesve të rremë.

Keni fituar shumë çmime të rëndësishme filmike. Sa e vështirë është që vendet e vogla të promovohen në skenën botërore filmike?

Festivalet janë një enigmë. Nuk jam i sigurt se sa është e rëndësishme madhësia e vendit për të pasur sukses, megjithatë gjatë viteve kuptova se ndonjëherë nuk është e rëndësishme cilësia. Me siguri, më të rëndësishmet për promovim të suksesshëm janë temat të cilat shpesh diktohen nga seleksionuesit dhe drejtorët e festivaleve, deri në atë masë, sa që ndonjëherë kam ndjenjën se ne regjisorët jemi pjesë e një ore mësimi në fillim të vitit shkollor në të cilën kemi si detyrë të shkruajmë një detyrë me shkrim me titull „si i kalova pushimet verore“, dhe për atë që kjo temë është e mërzitshme, dhe dëshiron që në mënyrë kreative ta kthejë diskutimin në anën tjetër, do të vlerësohet me notën „njësh“ sepse ka gabuar temën. Pa marrë parasysh këtë, nuk mund të ankojem me filmin „Shëruesi“. Fituam aq shumë çmime dhe festivale sa që i tejkaluan të gjitha pritshmëritë e mia.

Si identifikohen shikuesit e huaj me filmin?

Për kënaqësinë time filmi preku një publik shumë të ndryshëm nga kultura të ndryshme të rruzullit tokësor, dhe pothuajse nga të gjithë ngjarja e filmit u pranua shkëlqyeshëm dhe u kuptua ashtu siç e kisha menduar unë. Kjo është kënaqësi e madhe sepse konfirmon faktin se kornizat e saj janë pothuajse universale.

Pas suksesit të „Shëruesi“, a duhet të presim ndonjë temë të re nga Shkupi?

Akoma po pushoj dhe mendoj. Do të shohim së shpejti.



Ruaje portofolin, ruaje mjedisin jetësor

- Gjysma e atyre që shkojnë në punë me automobil në Shkup, gjatë ditës kalojnë vetëm 5 km.
- Në nivel vjetor mund të shmangni ngasjen e automobilit mbi 2600 km deri në punë
- Kursimi është 260 litra karburant ose 15.000 denarë
- Në ajër do të lëshoheshin mbi 500 kg CO₂ më pak



Ngas biçikletë!
Kurse kohë dhe të holla.




Ruaje portofolin, ruaje mjedisin jetësor

- **Udhëtarë:** një autobus zëvendëson deri në 50 automobila
- **Karburant:** një autobus harkhon 40 litra/100 km,
50 automobila harkhojnë 400 litra/100 km
- **Koha:** me automobil harkohen 30-60 min për 5 km
rrugë dhe gjetje të parkingut
- **Të holla:** ngasja e automobilit është 10 herë më e kushtueshme



**Përdore transportin publik!
Më shpejtë, më ekonomike
dhe më ekologjike!**



U SHËNUA 55-VJETORI I TËRMETIT KATASTROFIK TË SHKUPIT

FLET SHKUPI – TA RUAJMË DHE DUAM QYTETIN TONË

Me rreth njëzetë evenimente kulturore, ekspozita, performanca, muzikë dhe aktivizëm nga data 23 deri më 26 korrik Qyteti i Shkupit shënoi 55-vjetorin e tërmetit katastrofik që goditi qytetin në vitin 1963. Manifestimi „Flet Shkupi” gjatë këtyre katër ditëve bashkoi artet pamore, teatrore, filmike dhe multimediale dhe dërgoi mesazhin se nuk kemi harruar përkrahjen që morëm para 55 vitesh nga e gjithë bota dhe se e duam qytetin tonë, kulturën e tij dhe urbanistikën unike të cilën do ta kultivojmë edhe në të ardhmen.

SOLIDARITETI KTHEHET NË SHTËPI

Në suazat e shënimit të 55-vjetorit të tërmetit katastrofik të Shkupit, nën moton „Solidariteti kthehet në shtëpi”, më 23 korrik 2018 u shënuar kthimi i shkronjave të mesazhit të Josip Broz Titos në anën lindore të Muzeut të qytetit të Shkupit. Bëhet fjalë për mesazhin që presidenti i RSFJ-së ka dërguar më 27 korrik 1963, një ditë pas tërmetit katastrofik, i cili thotë: „Shkupi përjetoi një katastrofë të paparë, por Shkupin do ta ndërtojmë përsëri me ndihmën e të gjithë komunitetit tonë. Ai do të jetë simbol i vëllazërimit dhe unitetit, i solidaritetit jugosllav dhe botëror.”

Mesazhi që dëshmonte për një kohë të gjatë për solidaritetin që mori Shkupi nga e gjithë bota, dhe që ishte një pjesë karakteristike dhe e pandarë e Muzeut, që nga dita e sotme kthehet në vendin e vet. Këtë ua detyrojmë të gjithë njerëzve humanë, të cilët me përkrahjen e tyre altruiste u ndihmuan

shkupjanëve në momentet e rënda të tërmetit. Këtë ia detyrojmë edhe Torvald Stoltenbergut, qytetarit të nderit të Shkupit, njeriut që koordinoi aksionin humanitar të Kryqit të kuq norvegjez të dedikuar për qytetin tonë. Prandaj para 10 vitesh Stoltenberg u shpall qytetar nderi i Shkupit dhe sot, gjëja më e vogël që mund të bëjmë për nder të tij është që ndonjë rrugë në Shkup të mbajë emrin e tij. Në asnjë mënyrë nuk duhet t’i harrojmë këto njerëz. Nuk kemi të drejtë për këtë. Jemi të obliguar ta kultivojmë kujtimin e solidaritetit të tyre dhe me kthimin e mesazhit të Titos po bëjmë pikërisht këtë – shprehim falënderimin tonë për gjithçka që bënë për ne para 55 vitesh, në momentet më të vështira të historisë bashkëkohore të qytetit tonë – tha kryetari Shilegov në solemnitetin me këtë rast.

RRUGA E SOLIDARITETIT NËPËR SHKUP

Më 24, 25 dhe 26 korrik qytetarët dhe vizitorët e Shkupit kishin mundësi me autobusët panoramik ta shikojnë Shkupin me fokusin e ngjarjeve të lidhura me tërmetin katastrofik në vitin 1963. Stacioni i parë i Rugës së solidaritetit ishte vendi ku ka lindur Nënë Tereza, pikërisht parku para godinës së EVN-së në shesh. Pastaj, autobusi vazhdoi rrugën pranë Stacionit të vjetër hekurudhor, drejt lagjeve Taftalixhe 1 dhe 2 (lagje të ndërtuara me ndihmën e solidaritetit ndërkombëtar), përgjatë rrugëve „Varshavska”, „Prashka”, „Londonska”, „Oslo”, „Helsinki”, nëpërmjet „Moskovska” nëpër bulevardin „Partizanski odredi” kaloi përballë poliklinikës

„Bukuresht” (dhuratë nga Romania), pranë vendit të blloqeve të shkatërruara në Karposh 2, pastaj nga Salla universale (dhuratë nga Bullgaria), pastaj përgjatë blloqeve të „Gradski zid” (projekt i arkitektit Kenzo Tange), pastaj në afërsi të teatrit të vjetër dhe rreth ndërtesës së MOB, për të përfunduar në sheshin te shtëpia e lindjes e Nënë Terezës.

Kjo shëtitje u organizua nga NQP Turs, NQP Shkup dhe Qyteti i Shkupit.

NË SYTË E ARTISTËVE TË RINJ



Galeria e grafitëve në Qendrën tregtare të Shkupit më 25 korrik ishte nikoqire e evenimentit qendror në suazat e manifestimit „Flet Shkupi” me të cilin u shënuar 55-vjetori i tërmetit katastrofik.

- Vetëm gjatë një ditë-nate më 26 korrik 1963, u shfaq e gjithë drama ekzistenciale, personale dhe kolektive e cila dëshmon për tragjedinë e ekzistencës njerëzore. Kështu që, kur flasim për 26 korrikun fatal të vitit 1963, shndërrohet jo vetëm në nostalgji për Shkupin e vjetër, por edhe në imperativ etik i cili edhe sot e kësaj dite është pjesë e jetës së qytetit. Dëshiroj, që asnjëherë Shkupi të mos përballet me katastrofa natyrore të përmasave të tilla, siç ishte tërmeti i 26 korrikut të vitit 1963. Të përhapë optimizëm dhe të përpiqet, që në mjedisin tonë të sundojë një perceptim ndryshe i gjërave të cilat janë pjesë e pandarë e zhvillimit të këtij qyteti. Nga perspektiva e sotme, qyteti i Shkupit është konfirmim i së lartpërmendurës, dhe në të njëjtën kohë edhe nxitje e madhe dhe obligim për të gjithë ne së bashku, për ta ruajtur dhe dashur qytetin tonë – tha Shilegov.

Pas tërmetit katastrofik të parët që arritën për të ndihmuar shkupjanët ishin qytetarët e ish-republikave jugosllave, dhe menjëherë pas tyre edhe ekipet e shpëtimit nga e gjithë bota.

- Më shumë se 87 kombe dërguan ndihma dhe ndihmuan në ndërtimin e Shkupit të ri – „Qyteti i solidaritetit”. Pas tërmetit Shkupi i ri me kulturën e tij, me specifikën urbane, ekonomike, gjeografike, hapësinore, demografike dhe kulturore, bëhet një qytet modern – theksoi Shilegov.

Qytetarët e pranishëm në Galerinë e grafitëve kishin mundësi të shikojnë edhe projeksionin e kolazhit filmik me metrazh të shkurtër të regjisores së re Dina Duma të titulluar „Shkupi ëndërron” dhe performancën „Rikonstruksioni i qetë i tërmetit” të Biljana Radnoska, si dhe të argëtohen me programin muzikor „Bisedë me kuptim”, pikërisht me koncertin e Mammoth & Yashem, Todor Karakolev, sesion improvizues me muzikantë të skenës së re të Shkupit.

SHKUPI U ZGJUA NË ORËN 5:17 NËN ALARMIN E SIRENAVE



Më 26 korrik të këtij viti Shkupi u zgjua në orën 5:17 nën alarmin e sirenavë, si shenjë për të rikujtuar tërmetin katastrofik që ndodhi para 55 vitesh, në të njëjtën datë, në të njëjtën orë. Një grup artistësh urbanë nga Qendra e artistëve modernë realizuan audio-aksion pikërisht në orën 5:17 në pesë vende të ndryshme nëpër qytet duke u rikujtuar shkupjanëve kohën e saktë të kësaj ngjarje tragjike.

Me këtë audio-aksion, artistët urbanë dhanë kontributin e tyre origjinal në nderimin e kujtimit të viktimave të tërmetit dhe vendosën një dimension të ri në shënimin e kësaj tragjedie të Shkupit.

LULE NË NDERIM TË VIKTIMAVE TË TËRMETIT



Më 26 korrik të këtij viti në varrezat e qytetit në Butel delegacione vendase dhe të huaja vendosën lule para monumentit të viktimave në tërmetit katastrofik të Shkupit. Për nder të viktimave, kurorë me lule vendosi edhe delegacioni i Qytetit të Shkupit, i udhëhequr nga kryetari Petre Shilegov, si dhe delegacioni i Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Me vendosjen e luleve nderuan viktimat e tërmetit edhe delegacioni nga kabineti i kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, delegacioni nga kabineti i presidentit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, përfaqësues të partive politike, delegacione nga të gjitha

komunat e qytetit të Shkupit, përfaqësues të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe të Republikës së Maqedonisë, delegacioni i ARM-së, përfaqësues të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve kulturore të Qytetit të Shkupit dhe qytetarë. Lule vendosën edhe delegacione zyrtare të huaja, ndërmjet të cilave delegacioni nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina, Franca, Holanda, Federata Ruse dhe delegacioni i Bashkimit Evropian.

EKSPOZITË E CILA NA RIKUJTOI SOLIDARITETIN QË NDËRTOI SHKUPIN E RI



Ekspozita e fotografive, „Nga vëllazërimi dhe uniteti '63 deri te Shkupi '63“, me materiale arkivore dhe eksponate të aksioneve punëtore rinore dhe brigadave mbi shpatullat e të cilave u ngrit Shkupi i ri, e cila më 26 korrik u hap në Muzeun e qytetit të Shkupit shënoi fundin e serisë së evenimenteve të titulluara „Flet Shkupi“.

Muzeu i qytetit të Shkupit nëpërmjet kësaj ekspozite arriti të na afrojë shfaqjen për ndihmën e dhënë nga brigadat rinore nga të gjitha republikat e ish-Jugosllavisë të cilat me punën e tyre vullnetare bartën pjesën më të madhe të ngarkesës gjatë

pastrimit të rrënojave dhe ndërtimit të një pjese të madhe të objekteve të Shkupit të ri. Të rinjtë nga e gjithë Jugosllavia ngritën lagjet e para për qytetarët të cilët mbetën pa shtëpitë e tyre, morën pjesë në luftën për shpëtimin e jetëve njerëzore nën rrënoja, në varrimin e viktimave, por edhe në shumë aksione të tjera ku ishte e nevojshme në mënyrë emergjente fuqi punëtore – tha kryetari Shilegov, në hapjen e ekspozitës. Ai shprehu kënaqësinë e tij që një pjesë e pjesëmarrësve të këtyre brigadave ishin të pranishëm në Muze dhe i porositi se kjo ekspozitë me rastin e 55-vjetorit është vetëm një shenjë e vogël falënderimi për ndihmën e tyre altruiste në rindërtimin e Shkupit dhe se puna e tyre do të mbetet e gdhendur përjetësisht në pamjen e Shkupit të ri pas tërmetit, dhe me të, do të jenë përjetësisht pjesë e kujtimeve të të gjithë banorëve të qytetit dhe lajtmotiv për të vazhduar luftën e pandërprerë për Shkupin e ri, modern dhe urban.

-Shkupi është qytet për të gjithë. Shkupi është qytet edhe për ata që kanë lindur këtu, edhe për ata që kanë ardhur, por edhe për ata që kanë investuar, investojnë dhe do të investojnë një pjesë të vetes në bukuritë e tij. Shkupi ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë gëzimi ynë i përbashkët - porositi Shilegov. Në ekspozitë morën pjesë edhe përfaqësues të aksionistëve nga shumë vende të ish-Jugosllavisë, të cilët, që në ditën e dytë pas katastrofës në vitin 1963 erdhën për të ndihmuar në pastrimin e rrënojave. Për përpjekjet, angazhimet dhe ndihmën e tyre kryebashkiaku Shilegov u ndau mirënjohje. Qytetarët e pranishëm në Muzeun e qytetit të Shkupit, në mbrëmje, gjithashtu kishin mundësi të ndiqnin leximin e poezive nën moton „Për Shkupin që dua“ nën organizimin e Grave të Qytetit të Shkupit, si dhe të shikojnë filma nga kinoteka e Maqedonisë për TËRMETIN E SHKUPIT.

Të njëjtën mbrëmje në Muzeun e artit modern u hap ekspozita e veprave të autorëve grekë, kurse në Qendrën kulturore rinore kishte projeksione të serisë „Dosja Shkupi“ dhe program të pasur muzikor. Tradicionalisht, më 26 korrik u mbajt gjithashtu aksion për dhurimin e gjakut të organizuar nga Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit, ndërsa këshilli organizativ vendosi lule para monumentit të viktimave të tërmetit në varrezat e qytetit në Butel.





ROMA ROCK SCHOOL - KJO ËSHTË HISTORIA E TYRE!

ROMËT DHE MUZIKA

Për një numër të madh romësh në të kaluarën burimi themelor i ekzistencës ishte muzika. Ata ishin argëtues të cilët përdornin instrumente të ndryshme, këndonin dhe vallëzonin me qëllim që të fitonin për familjet e tyre. Pothuajse asnjë prej tyre nuk ka pasur edukim adekuat për instrumentet, por edhe përkundër kësaj ata zotëronin në mënyrë të përkryer instrumentet duke mësuar nga paraardhësit e tyre pa poseduar asnjë njohuri elementare për leximin e notave. Ata përdornin talentin e tyre, punën këmbëngulëse, ndjenjën dhe veshin për muzikë.

Edhe sot e kësaj dite nuk ka ndryshuar shumë, dhe, as nuk është bërë ndonjë gjë për të nxitur, fuqizuar, inkurajuar, motivuar ose stimuluar talentin muzikor të romëve. Pas themelimit të Fakultetit të artit muzikor në Shkup në vitin 1966 dhe Akademisë së muzikës në Shtip në vitin 2007, deri më sot, në Maqedoni nga 53.879 banorë romë (ndërkohë që sipas statistikave të Këshillit të Evropës ky numër është ndërmjet 134.000 dhe 260.000 banorë), romë të diplomuar në fakultetet e muzikës janë vetëm 12.



CILI ËSHTË PROBLEMI APO SFIDA?

Edhe pse Shuto Orizari ka shumë të rinj inteligjentë dhe të talentuar, aksesit deri te instrumentet muzikore dhe orët e muzikës për shkak të varfërisë së prindërve të tyre është i pamundur. Paradoksi është më se i qartë: gjendja e vështirë ekonomike e prindërve kufizon mundësitë për arsimin e fëmijëve, sipas të cilëve arsimi muzikor përbën një ëndërr të pamundur për t'u realizuar.

SI LINDI IDEJA PËR RRS-NË?

Motivi kryesor për themelimin e kësaj shoqate është talenti muzikor i padiskutueshëm i romëve si komunitet. Por, edhe përpos faktit se romët janë një komunitet i talentuar muzikor, për fat të keq, numri i romëve të arsimuar është shumë i vogël. Pikërisht ky është një nga qëllimet kryesore të „Roma Rock School”, rritja e numrit të romëve të arsimuar.

Dihet se romët talentin e tyre muzikor e kanë shprehur në drejtime të ndryshme muzikore, por deri tani asnjëherë nuk është bërë ndonjë lidhje ndërmjet rokut, hevi- metal, rokut progresiv dhe melosit tradicional rom. Fokusi i „Roma Rock School” është pikërisht ai – krijimi i një drejtimi krejtësisht të ri në muzikë.

PROJEKTI „ROMA ROCK SCHOOL”

Projekti „Roma Rock School ” u financua nga organizata zvicerane FRIEDENSBRUGG (Bridge of Peace) dhe zgjati nga shtatori deri në dhjetor të vitit 2017.

Qëllimi i projektit ishte formimi i rok-bendit me nxënës të talentuar romë, plotësimi i arsimit muzikor të tyre, veçanërisht nga fusha e muzikës rok.

Ekipi i „Roma Rock School” më 15.09.2017 në SHF „Vëllezërit Ramiz-Hamid” organizuan audicion për nxënësit e talentuar në muzikë në të cilin u





paraqitën 17 nxënës. Për anëtarë të bendit "Roma Rock School" u zgjodhën 6 nxënës:

1. Valentino Aljush - Kitarë/Vokal
2. Melas Sejfulov - Kitarë
3. Omer Shaban - Klarinetë
4. Samuel Sulejman - Piano
5. Gjolhan Abdiev - Bateri/Perkusi
6. Trajman Vejsel - Bateri /Perkusi

Nxënësit nën kujdestarinë e Nevruz Bajram dhe Alvin Salimovski tre muaj ushtruan dhe krijuan në një farë mënyre një zhanër të ri muzikor – këngë rok nga bende të njohura botërore me karakteristika të muzikës tradicionale rome.

Disa prej tyre nuk kanë asnjë lloj arsimit muzikor, kurse një pjesë e tyre kanë ndjekur arsimin e ulët muzikor, por asnjëherë nuk kanë pasur mundësi të interpretojnë para publikut dhe të tregojnë talentin e tyre, të luajnë në koncert, të ushtrorjnë në studio muzikore dhe të luajnë së bashku me personalitete të njohura të muzikës rok në Maqedoni.

Për të realizuar qëllimin e projektit ushtrimi i përditshëm ishte i domosdoshëm gjë për të cilën ekipi i "Roma Rock School" siguroi pëlqimin e prindërve të anëtarëve të bendit dhe në të njëjtën kohë anëtarëve të bendit u vuri si kusht që nëse duan të jenë anëtarë të rok-bendit duhet të kenë sukses në mësimet me notë mesatare të paktën 3,5. Ky kusht ishte motivim për arritjen e suksesit të mirë në shkollë, dhe në të njëjtën kohë për të qenë



anëtar i bendit.

Nga ekipi provat e fundit u organizuan në studion muzikore nën kujdestarinë e një këngëtarit të mirënjohur të muzikës rok të skenës maqedonase, që për anëtarët e rok-bendit ishte një surprizë dhe mundësi e vërtetë për të luajtur në një studio të vërtetë muzikore, që realisht, nëse nuk ishin anëtarë të "Roma Rock School" nuk do ta kishin kurrë atë mundësi.

Koncerti përfundimtar i "ROMA ROCK SCHOOL" u mbajt më 16.12.2017

në Marakana, Shkup dhe në të morën pjesë rreth 300 mysafirë që për ne ishte një surprizë dhe kënaqësi e jashtëzakonshme. Morën pjesë përfaqësues të ambasadave, organizatave joqeveritare, mësues dhe profesorë të shkollave të muzikës, përfaqësues të Korpusit të paqes në Republikën e Maqedonisë dhe një numër i madh mysafirësh, të cilët ishin të befashuar nga përzierja e muzikës rok me elementë të muzikës tradicionale rome.

NJIHU ME shkupjanët

#Zapoznajgiskopjani është një nismë e iniciuar nga Skopje Lab – Qendra për inovacione e Qytetit të Shkupit. Qëllimi i kësaj nisme është prezantimi i pamjes aktuale të Shkupit dhe tregimet e qytetarëve që jetojnë dhe punojnë në kryeqytet. Vullnetarët e Skopje Lab mbledhën deklarata të shkurtra dhe fotografi nga kalimtarë të zakonshëm nëpër qytet, të cilët flasin për problemet reale që ekzistojnë në të. Motivacioni i tyre është që ky projekt t'i afrojë vetë shkupjanët me Shkupin tonë. Këto janë ndjenjat e tyre, përjetimet, dëshirat dhe sugjerimet për Shkupin.

”

Shkupi është qytet për rilindje rinore, kulturore. Më shpesh na kujton shtëpinë, Maqedonia, "Karposh" 1, 2 dhe 3, "Debar Maalo", QKR, "Crno", "Park", "Skopsko", beton, dhe më e rëndësishmja DASHURI dhe DUPER. Ky qytet posedon liri, larmi, por edhe gjëra jo të përkryera. Diçka që me të vërtetë i mungon është ajri i pastër, kultura në trafikun rrugor, respekt më i madh ndaj çiklistëve dhe korsive të tyre, optimizëm më i madh, më shumë muzikë dhe kioska që punojnë 24 orë. Në fakt e duam Shkupin ashtu siç është! Duhet të fuqizohet aktiviteti rinor dhe kreativiteti i tyre. Të garojnë shumë më tepër, por edhe të mbështesin njëri tjetrin në çdo sferë. Jeta kulturore dhe ajo e natës këtu janë unike. Gjithmonë mund të gjesh vend ku të shkosh, asnjëherë nuk është mërzitshëm. NE si DUPER pa dyshim deri tani kemi hapësirë që të shprehemi në qytet, për më tej do të shohim. Gjithsesi DUPER-in e shikojmë në qytet si diçka të re dhe interesante, si një bend të suksesshëm..." **DUPER**



”

Unë i përka s gjeneratës së vjetër, në kohën time jeta shikohej nga një këndvështrim tjetër, e jo si tani. Nuk kam lindur në Shkup, por ndjehem mirë në të. Unë jam këtu që nga rinia ime, e di që kur ishte i vjetër dhe i pazhvilluar, e deri në ditët e sotme. Më pengon trafiku në këtë qytet, është shumë i tensionuar. Ka një mungesë kulture të madhe, edhe shoferët edhe këmbësorët janë shumë të pakulturuar dhe të paarsimuar. Do të desha të kemi ndonjë Diznilend të vogël ose disa parqe që të rinjtë të heqin dorë nga veset e këqija. Gjithashtu, nëse ekziston dhe realizohet projekti "Ultësira e Vardarit" nga Selaniku deri në Dortmund do të jetë me rëndësi të madhe për të gjithë popujt dhe shtetet, është me prosperitet..." **Udhëtar i vjetër tregtar**

”

E duam Shkupin, këtu kemi lindur, jemi rritur, plakur... Shkupi është vendlindja jonë. Edhe pse, kemi shikuar shumë gjëra duam të shikojmë diçka të re. Ndonjë ndërtesë të bukur dhe të re, muze, ndonjë gjë interesante. Ne nuk lëvizim shumë dhe është vështirë të themi çfarë duhet të ndryshojë, por dëshirojmë që të kemi më shumë stola për të ndenjur, më shumë kosha për mbeturina, më shumë pemë dhe parqe të tilla. Ne jemi gjyshe të vjetra, shkupjane ..." **Ljupka dhe Ljubinka**





Shkupi – shtëpi, fëmijëri, shëtitje, kujtime të bukura. Kur nuk jam në Shkup më kap nostalgjia. Thjesht ndjem shumë e relaksuar kur jam këtu. Mendoj se nëse ekziston ndonjë vend ku njeriu ndjehet i relaksuar, në ndonjë hapësirë, ai mund të arrijë potencialin e tij më të madh. Nuk më pëlqejnë disi karakteret e ndryshme në Shkup, por kam njohur shumë njerëz që padyshim më kanë ndryshuar jetën, andaj edhe jam shumë e lidhur me qytetin. Ato momente që i kam ndarë me njerëzit, të afërmit, miqtë... Të kisha fuqinë për të ndryshuar diçka, gjëja e parë do të ishte mënyra e edukimit të fëmijëve sepse me atë fillon dhe më tej vazhdon gjithçka. Diçka tjetër që do të ndryshoja është gjithsesi transporti publik. Duke udhëtuar nëpër shumë qytete të tjera kupton sesa është i rëndësishëm në fakt transporti publik, pamja, shpejtësia dhe organizimi i tij. Në fakt, transporti ndryshon shumë, pikërisht i gjithë qarkullimi nëpër qytet. Secili të ketë mundësi të përfundojë një punë të caktuar pa asnjë lloj nervozizmi duke shfrytëzuar transportin publik. Nga ana tjetër njerëzit do të jenë më produktivë, më të lumtur dhe më të qeshur pa tension gjë e cila nuk ekziston. Por, këtë mund të presim ta ndryshojnë vetëm ata të cilët janë në pushtet, sepse, ne nuk mund të bëjmë asgjë. Gjithsesi na mungon më shumë jetë kulturore, koncerte, bende, interpretues, Shkupi të ngrihet ca më tepër nga ana kulturore. Vendi im i preferuar pa dyshim është Parku dhe mendoj se e dimë pse..." **"Gemixhijka" potenciale**



.....



Pa dyshim Shkupi më ofron party funky-disco, qëllimi im është që një të tillë të bëjë unë vetë, ndoshta dikush tjetër do të më përkrahë. Në këtë kontekst të bëjmë diçka që do të ketë karakter argëtues ku njerëzit do të ndjehen të lirë. Të argëtohem siç duam ne, sado që të dukej e çuditshme dhe qesharake. Të jemi pa shtrëngime nga gjykimi i dikujt, pa turp për sytë përreth. Të vallëzojmë sikur askush të mos na shikojë. Të argëtohem të shkujdesur. Më konkretisht pse nuk jam i kënaqur nga Shkupi?! Jetoj në "Debar Maalo". "Debar Maalo" është një katastrofë e plotë dhe duhet të ndërpritet çdo ndërtim. Duhet të rrënohet gjysma e "Debar Maalo" sepse është klaustrofobike, nga ana tjetër është konstatuar nga ana shkencore se ndërtesat e larta, pikërisht urbanizimi çon në një shkallë më të lartë depresioni dhe vetëvrasjesh. Ajo që dua të shikoj në Shkup janë sipërfaqe më të mëdha gjelbërimi, parqe... Nuk kam shikuar lulishte në qytet. Dua shtëpi me oborre. Dua oborre me kopshte me lule. Dua ndërtesa komuniste të mbuluara me bimë kacavjerrëse. Adhuroj kontrastin e thjeshtësisë së thatë gri, dhe nënshtrimin e saj nga natyra. Me fjalë të tjera, dua gjelbërim, ta mbulojmë gjithë qytetin, dhe të mahnitemi me bukuritë e natyrës. Kohëve të fundit Kalaja për mua filloi të jetë gjëja më e preferuar në Shkup, nuk e di pse, kur më përmend Shkupin gjëja e parë që më bie ndërmend është pikërisht ajo. Ndoshta, sepse kur shkoj për në fakultet më këmbë, e shikoj. Njëlloj kur më përmendin Shkupin më bie ndërmend edhe Vodno. Mendoj se duhet t'i shikojmë këto dy gjëra si simbolet tona..." **"Vizionar**

.....

*Në faqet e mësipërme deklaratat e qytetarëve janë dhënë në mënyrë autentike

#ZapoznajgiSkopjani mund ta ndiqni në:



Instagram

www.instagram.com/zapoznajgiskopjani/



Facebook

<https://www.facebook.com/skopjelab/>

Me iniciativën e artistit Filip Koneski, dhe nën organizimin e Qendrës kulturore rinore, Qytetit të Shkupit dhe Qendrës tregtare së qytetit – Shkup, u realizua galeria e parë në ambient të hapur, e titulluar „Qyteti i bukur”, e cila iu kushtua artit të rrugës dhe kulturës së grafitëve.

Si pjesë e programit CreArt (Network of Cities for Artistic Creation), në bodrumin e QTQ-së, tek stacioni i autobusit, u integrua galeria ku 21 autorë krijuan veprat e tyre të cilat i dhanë një frymë të re, të freskët dhe autentike njërit prej objekteve më të rëndësishme të Shkupit modern. Me veprat e tyre morën pjesë:

Antonio Ilievski - Pig Hands, Blazhe Atanaskov - Name, Davor Qeshqec, Dragan Kitanovski – Drash, Ermal Musoviq - nak47, Vasil Dimovski – Strajk, Cvetan Nedelkovski – Krom, Irina Conevska, Ivan Petrushevski – FLIM, Marjan Dimiq – Mačka, Miroslav Grčev - Miro Miks, Mladen Trendevski – Trendo, Sali Ertunc, Sanja Simoska, Selmir Alimi – ESIEM, Mihail Galevski - MG. MORGAN, Zoki Mishe - SHUMA, Trajçe Pavlov - .TAC., Vladimir Miliq - Vutar EBSF, Voskresija Andreevska dhe Filip Koneski.

Autorët u përzgjedhën nëpërmjet thirrjes e cila u shpall nga Qendra kulturore rinore dhe e njëjta ishte e hapur për artistët vendas dhe të huaj nga fusha e artit të rrugës dhe grafitëve. Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje ishte krijimi i hapësirës për autorët vendas për të realizuar një vepër kushtuar Shkupit, që këtë vit shënon 55-vjetorin e rindërtimit nga tërmeti katastrofik i vitit 1963. Përveç promocionit të artistëve vendas para publikut, me këtë ndërhyrje iu dha një funksion plotësues këtij ambienti arkitektonik atraktiv.

Evenimenti u realizua më 15 dhe 16 qershor, kurse më 17 qershor 2018 ishte hapja zyrtare e galerisë. „Qyteti i bukur” është tema me të cilën filluam këtë projekt kulturor unik.

Vijojnë intervista të shkurtra me disa nga autorët të cilët morën pjesë në krijimin e „Qyteti i bukur”:


QYTETI I BUKUR MBIU PËRSËRI

MLADEN TREDEVSKI – TREDO:

Ashtu siç thatë një nga objektet e pakta të Shkupit modern të ruajtura është QTQ-ja, që në të njëjtën kohë ishte edhe sfida dhe mundësia që arti im modern të jetë pjesë e shkrimit të një historie për Shkupin dhe gjeneratave të ardhshme. Vepër e cila shpresoj të mbetet vite të tëra dhe se ndonjë ditë gjeneratave të e ardhshme do ta pranojnë më shumë në vetë shoqërinë. Vizatimi i grafitëve natën për mua përbën liri më të madhe për artistin e grafitëve, ku vetë veprën të cilën e ke memorizuar në tru e përshtat sipas sipërfaqes, çdo murr i qytetit është në dispozicionin

tënd dhe të thërret. Pengesa e vetme është policia. Bukuria e vizatimit të grafitit i cili është i organizuar dhe pa trysni, qëndron në faktin që shoqëroresh me njerëz që mendojnë si ti dhe para së gjithash janë shokë, të gjithë së bashku ndërtoni një kulturë moderne. Kuptohet vizatimi legal të krijon hapësirë për t’u përkushtuar më mirë grafitit tënd.

Shkupit gjithmonë i kanë munguar evenimente të një karakteri të tillë ku gjeneratat më të reja do të kenë hapësirë për të krijuar kulturën e tyre, ku do të lënë gjurmët e tyre për gjeneratat e ardhshme në Shkup. Të dinë se edhe atëherë ekzistonte diçka që ka qenë pjesë e ndonjë kulture urbane. Evenimenti është për t’u përshëndetur, shpresoj, se do të shihemi së shpejti, me të njëjtat ide dhe realizime.



VOSKRESIJA ANDREEVSKA:

Unë kam shpirt artisti, ëndërroj dhe besoj si edhe shumë të tjerë këtu në Maqedoni se nëpërmjet lëvizjeve të tilla artistike do të mundemi të ringjallim Shkupin tonë të hirtë. Ndërmjet të tjerash, muret publike të QTQ-së, tingëllonin si një telajo emocionuese në të cilën prisja me padurim të vizatoja. Besoj se ia „forcuam themelet“ në një periudhë më të gjatë. Krijimi është shumë i ndryshëm. Kur isha më e vogël, isha e mahnitur nga ato mbrëmje adrenaline duke lënë fjalë të parëndësishme në muret e mëhallës sime. Bëja skica në fletoret e shkollës, blija spreje të lira, fusja maskën në çantë dhe shumë e emocionuar vrapoja që t'i harxhoja sa më shpejt. Dallimi me këto evenimente të organizuara sot, është se nuk duhet të shqetësohesh nëse do të përfundosh në ndonjë stacion policor. Ke realitetin dhe kohën në anën tënde, ndjenja të bukura, mbështetje dhe lavdërime. Në të njëjtën kohë, publiku mund të pranojë në mënyrë shumë më të lehtë një vepër të krijuar në suazat e një eventi të tillë, kurse për ne kreativët është shumë e rëndësishme që kultura e grafitit ekziston si mjet për shprehjen e individit.

Shkupit i mungon pak, dhe kjo pak fillon me fjalën ndërgjegjësimi. Kur them ndërgjegjësimi mendoj për atë se si jetojmë, të vetëdijshëm për të tjerët, mjedisin, natyrën dhe botën. Mendoj se jetojmë në mënyrë shumë komode me vesin për të qenë të ligj njëri me tjetrin, nervozë dhe negativë. Që një njeri të shpërthejë nga ana artistike është e nevojshme dashuri.


**SEMIR ALIMI – ESIEM:**

Për mua ishte nder i madh të lë gjurmët e mia në një objekt të tillë të bukur dhe të vlerësuar siç është QTQ-ja, dhe në të njëjtën kohë të jem pjesë e një projekti të madh dhe me shumë rëndësi siç ishte „Qyteti i bukur“. Gjithashtu, ishte nder për mua që isha në shoqërinë e artistëve të grafitëve nga e gjithë Maqedonia. Dallimi i krijimit të veprës (grafitit) në kushte autentike nga ato të ashtuquajtura „vizatime ilegale“ qëndron në faktin se mënyra e realizimit të veprave në „Qyteti i bukur“ – në mënyrë të organizuar dhe pa trysni, të jep më shumë kohë dhe energji për ta krijuar në mënyrë sa më të saktë, kurse kur vizaton natën duhet të vizatosh nën adrenalinë dhe të jesh i kujdesshëm që mos të të kapin. Për mua si artist i grafitëve të dy aksionet kanë anët e tyre të bukura.

Se sa më mungon që Shkupi të ringjallet nuk mund ta përshkruaj me fjalë. Por, mendimi im është se Shkupit i duhen më shumë projekte siç ishte ky i grafitëve dhe street art.

DAVOR QESHQEC:

Ishte sfidë sepse QTQ-ja është një nga objektet e mia të preferuara në Shkup. QTQ-ja ka lënë gjurmë të thella tek unë, dhe që këtu sfida që edhe unë të lë gjurmët e mia në të. Dallimi qëndron në faktin se kur krijon një vepër natën dhe nën veprimin e adrenalinës që mos të të kapin, nuk mund t'i përkushtosh shumë kohë veprës tënde të cilën e krijon dhe nga ana tjetër shikon që ta mbarosh sa më shpejt për arsyet e lartpërmendura. Kur punon në mënyrë të organizuar dhe pa trysni si në „Qyteti i bukur“ ke më shumë mundësi dhe kohë për realizimin e veprës. Ajër i pastër, shumë parqe dhe gjelbërime, murale në fasadat e ndërtesave, arti i rrugës dhe grafitë, arkitekturë moderne dhe monumente moderne.





„SHKUPI“
LAJMËTARI INFORMATIV
I QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i Lajmëtari informativ
të Qytetit të Shkupit
„SHKUPI“ doli më 10 dhjetor 2008

REDAKTORI KRYESOR DHE PËRGJEGJËS
Valon Salihu

REDAKSIA
Seksioni për marrëdhëniet me publikun
i Qytetit të Shkupit

PËRKTHYES DHE LEKTOR
Vladimir Bogdanovski

FOTOGRAFITË
Mladen Bogojevski
Zoran Shekerov

BASHKËPUNËTORË NË KËTË NUMËR

Zoran Shishkovski,
Seksioni për sport dhe të rinj i Qytetit të Shkupit

Antonio Pavlovski,
Seksioni i kulturës i Qytetit të Shkupit

Sonja Ismail,
Qendra kulturore rinore

Skopje Lab – Qendra për inovacione
e Qytetit të Shkupit

e-mail
gragjani@skopje.gov.mk

Telefon
3 297 255

Facebook
Qyteti i Shkupit

Twitter
@CityofSkopje

Instagram
@gradskopje.ocialna

BOTON QYTETI I SHKUPIT
Bulevardi Ilinden 82
www.skopje.gov.mk

Dizajni dhe botimi
Pecatnica „Serafimovski“ Skopje

ZORAN MISHE – SHUMA:

Kam vizatuar në Shkup dhe çdo vizatim i imi ose është fshirë ose objekti është rrënuar, kështu që ky ishte një rast i mirë për të lënë vulën time në kryeqytet, së bashku me artistët e tjerë. Fakti që vepra është e QTQ-së, e rrit kënaqësinë në mënyrë plotësuese. Ka dallim, por duke ditur që më parë çfarë të pret, përgatitesh sipas vendit dhe kohës, por adrenalina gjithsesi ekziston edhe në të dy variantet. Qytetin e bëjnë njerëzit, arsimi, kultura dhe estetika. Duke pasur parasysh këto gjëra, punët do të rregullohen vetë.

MARJAN DIMIQ – MAÇKA:

Pikërisht për këtë, QTQ-ja është një nga objektet bashkëkohore të rralla që është ruajtur dhe është nder i veçantë të jesh pjesë e një evenimenti të tillë dhe të lësh gjurmët e tua në të. Dallimi qëndron në faktin se „Qyteti i bukur“ ishte jo vetëm eveniment në të cilin vizatohej në çfarëdolloj sipërfaqesh... ai ishte eveniment me ide të plotë, në të cilin ishin lidhur qyteti dhe QTQ-ja, me sipërfaqe murri para së cilës mendoj se të gjithë artistët ndjeheshin në të njëjtën kohë të vetëdijshëm dhe të nderuar.

Shkupi ka shumë ndërtesa me mure të zbrazëta të cilat janë një kapacitet potencial për ndonjë shprehje artistike. Mendoj që kjo do të jetë një nga kontributet e vogla dhe të vlefshme që Shkupi të ringjallet përsëri.

DRAGAN KITANOVSKI – DRASH:

Jo vetëm në QTQ, por kudo që të vizatohej do të merrja pjesë. QTQ-ja është objekt me të cilin më lidhin kujtime të shumta nga fëmijëria dhe kjo ishte edhe një nga arsyet për të marrë pjesë në projekt. Dallimi është shumë i madh, sepse ke kohë t'i përkushtohesh grafitit dhe detajeve. Shoqërimi me artistët e tjerë është gjithashtu një plus shumë i madh. Kur vizaton në kushtet të tjera shikon të përfundosh sa më shpejt. Megjithatë, të dy mënyrat e vizatimit kanë bukurinë e tyre.

Mungojnë më shumë projekte të tilla, të mos mbesim vetëm me këtë. Me evenimente të tilla qyteti ka më shumë shpirt. Pushteti duhet të jetë më i hapur për bashkëpunim me autorët vendas dhe duhet të ketë mirëkuptim më të madh për këtë mënyrë të shprehuri. Shkupi ka potencial të madh për më shumë projekte të tilla, sepse ka shumë mure të cilave u mungon ngjyra.



*Intervistat e autorëve janë transmetuar në mënyrë autentike

NË PERIUDHËN E ARDHSHME, MOS LËSHONI!

	QKR	NATA E BARDHË
	28.09 ROLLER DISCO Parku i qytetit	06.10 Festival of Light
QIK	KOPSHTI ZOOLOGJIK SHKUP	QKR
18 - 29.09.2018 Ekspozitë e fotografive nga Vojko Janevski - 50 - vjet krijimtari artistike	29.09 Arritja e elefantëve Dunja dhe Daela	07. - 11.10 DZIFONI - Festivali i filmit për fëmijë
FILARMONIA MAQEDONASE		FILARMONIA MAQEDONASE
27.09 MËNGJES I RI Dirigjent JERUHAM SAROVSKI Solist LUKA DEBARG Programi: S. Prokofjev: Koncert për piano dhe orkestër nr.2 H. Berlioz: Simfoni fantastike, op.14		12.10 HARMONIJA MUNDI Dirigjent EMIL TABAKOV Solist GJORGJI CINCIEVSKI Programi: E. Tabakov: Koncert për kontrabas dhe orkestër G. Holst: „Planeti”
QKR		
27.09 NadahElShazly (Egjipt) MOT+ koncert		
	MUZEU I QYTETIT TË SHKUPIT	QKR
	02.10. Ekspozitë e veprave të artit pamor nga Slavko Janevski	12.- 13.10 SkopjeVinylConvention Koncert dhe panair muzikor
OPERA DHE BALETI MAQEDONAS	QIK	
28.09 „KARMINA BURANA” – Karl Orf	2 - 16.10. 2018 Ekspozitë e fotografive nga Nikola Ganevski	
	QKR	QKR
	03. - 10.10 KINENOVA Festivali i filmit	12. - 17.10 Java e filmit gjerman Festivali i filmit
QKR	QKR	
28.09 Fire (Suedi) MOT + koncert	04. - 05.10 Nga brinja deri në Rockandroll Festivali i muzikës – Allgirlbands	

